

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË** – Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari Beqir Kalludra, dhe gjyqtarët profesionistë Shadije Gërguri dhe Violeta Namani, anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Driton Berisha, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.H, për shkak të veprës penale të Grabitjes në vazhdimësi të parashikuar nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së lidhur me nenin 81 të KPRK-së, si dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda PP.nr.2-2/2010 të dt.09.02.2010, të ricilësuar gjatë shqyrtimit gjyqësor, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor me dt.20.07.2018, në të cilën kanë prezantuar prokurori i shtetit Armend Hamiti, i akuzuari A.H dhe mbrojtësi i tij av.Sh.B sipas autorizimit, me dt.20.07.2018 mori dhe të njëjtën ditë shpalli publikisht këtë:

### A K T G J Y K I M

I akuzuari A.H, i biri i M. dhe F, e gjinisë K, i lindur më ..., në fshatin Z.i U, komuna e D, ku edhe tani jeton, i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme teknike, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qëndruar në paraburgim prej 01.01.2010 e deri më 02.03.2011.

### Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

1. I pandehuri me dt.16.12.2009, rreth orës 18:23 min., në fshatin Krajkovë, komuna e Drenasit, me qëllim që vetes të i sjell dobi pasurore të kundërligjshme në atë mënyrë që e ka detyruar të dëmtuarin A.Sh me profesion taksist, të cilin e ka takuar te "Tre Sheshirat", në Prishtinë, ka kërkuar nga ai për ta dërguar në fshatin Komaran, me veturën e tij të tipit "Golf 4", me ngjyrë të verdhë, me targa të regjistrimit ... dhe për shërbim janë marrë vesh që i pandehuri të paguajë 25 euro (njëzetepesë) euro të dëmtuarit, por kur kanë arritur në fshatin Krajkovë i pandehuri e ka kërcënuar të dëmtuarin me armën e zjarrit të tipit të panjohur, të cilën ia ka drejtuar në drejtim të kokës duke i thënë "qiti paret, telefonin, çelësat e kerrit dhe mos fol se të vras", me ç'rast ia ka marrë të dëmtuarit rreth 110 euro (njëqind e dhjetë) euro, telefonin mobil të tipit "Nokia", por në momentin kur i pandehuri ka dalë nga dera e pasme e veturës për tu ofruar tek dera e vozitësit, me qëllim që t'ia marrë edhe çelësat e veturës të dëmtuarit, atëherë i dëmtuari e ka shty të pandehurin me derën e veturës dhe me shpejtësi ka arritur të largohet nga ai vend, ndërsa i pandehuri ka shtënë me revolen e tij 3 herë, dhe pas kësaj i dëmtuari e ka lajmëruar policinë.

2. I pandehuri me dt.24.12.2009 i përgatitur me revole dhe qëllim të njëjtë si në rastin në pikën 1 të dispozitivit ka shkuar në Pejë, ashtu që e ka takuar të dëmtuarin G.K me profesion taksist, ka kërkuar nga ai që ta dërgoj deri në Drenas, me të cilin është marrë vesh që shërbimi të paguhet 40 (katërdhjetë) euro, pastaj janë nisur me veturën e të dëmtuarit të tipit "Opel Vectra", me ngjyrë hiri metalike me targa ..., e pasi që kanë arritur në vendin e njëjtë si në rastin e parë, i pandehuri e ka nxjerrë revolen e tij nga brezi dhe nga ulësja e pasme e veturës ia ka vënë në kokë

revolen të dëmtuarit dhe nën kërcënimin e armës ia ka marrë 60 (gjashtëdhjetë) euro, një kuti të plastikës me 92 (nëntëdhjetë e dy) euro të metalta, një rreth të gishtit të arit, tre telefona mobil të tipit “Nokia”, si dhe dy sim-kartela, dhe në fund i është kanosur të dëmtuarit me fjalët “mos e lajmëro policinë se të vras”, dhe është larguar në drejtim të panjohur.

**3.** I pandehuri me dt.28.12.2009, rreth orës 17:30 min., ka shkuar në qytetin e Mitrovicës duke përdorur mënyrën e njëjtë si në rastet e sipërcekura në pikën I dhe II të dispozitivit, ashtu që ka kontaktuar të dëmtuarin A.F me profesion taksist dhe ka kërkuar që ai ta dërgoi në një fshat afër Arllatit, komuna e Drenasit ku janë marrë vesh paraprakisht për çmimin 40 (katërdhjetë) euro, dhe i pandehuri është ulur në ulësen e pasme të veturës së të dëmtuarit e cila ka qenë e tipit “Mercedes-E Class” me targa ..., me ngjyrë të gjelbertë metalike, ku edhe kësaj here i pandehuri ka përdorur rrugën si në rastin e parë dhe në momentin kur janë ofruar afër një pylli, i pandehuri ka nxjerrë revolen e tij të tipit të panjohur e ka përgatitur dhe ia ka drejtuar të dëmtuarit në kokë nga ana e pasme dhe ka kërkuar nga i dëmtuari “të gjitha paratë, arin dhe telefonat ose do ta vras”, i cili me atë rast nën kërcënimin e armës është detyruar t’ia jap të pandehurit: orën e dorës të arit në vlerë 1200.00 (njëmijë e dyqind) euro, dy unazat e arit në vlerë prej 130.00 (njëqind e tridhjetë) euro, zinxhir komplet i qafës dhe i dorës të arit në peshë rreth 200 gram që kushtojnë rreth 2000.00 (dymijë) euro, para të letrës dhe të metalta në shumë mbi 200.00 (dyqind) euro, dy telefona të tipit Nokia-6300 në vlerë prej 300 (treqind) euro, si dhe një sim kartelë të Valës, dhe pasi që i ka marrë këto i pandehuri është larguar në drejtim të panjohur për t’u arrestuar në fshatin Zabel i Ulët, në komunën e Drenasit, me dt.01.01.2010, rreth orës 15:45 min., ku pas kontrolles policore tek i pandehuri janë gjetur sendet e grabitura në rastet e lartëcekura ku një pjesë të tyre e ka shitur.

-me këtë ka kryer veprën penale Grabitje në vazhdimësi të parashikuar nga neni 255 par 3 lidhur me par.1 të KPK-së, e lidhur me nenin 81 të KPRK-së

Prandaj gjykata konform dispozitave 2, 3, 34, 38, 64, dhe 255 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së lidhur me nenin 81 të KPRK-së si dhe nenet 359, 365, 366, 368, 450, 453 dhe 463 të KPPRK-së, e:

## **G J Y K O N**

**ME DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite, i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e në të cilin dënim do t’i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt.01.01.2010 deri më dt.02.03.2011.

Detyrohet i akuzuari që t’i paguaj shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërkaq në emër të paushallit gjyqësor, shumën prej 100 (njëqind) euro, të cilën duhet të paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të dëmtuarit A.Sh, Gazmend Krasniqi dhe A.F, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

Kundër të akzuarit A.H, konform nenit 363 par.1 pika 1.1. të KPPRK-së,

## REFUZOHET AKUZA

Për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK-së, për shkak se prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza për këtë veprë penale.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, ka paraqitur aktakuzë PP.nr.2-2/2010 të dt.09.02.2010, kundër të akuzuarit A.H për shkak të tri veprave penale të Grabitjes të parashikuar nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së, si dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK-së.

Trupi gjykues i Gjykatës së Qarkut me Aktgjykimin P.nr.43/2010 të dt.02.03.2011, të akuzuarin A.H e ka shpallur fajtor për veprat penale si në hyrje të këtij aktgjykimi, duke i shqiptuar dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite. Gjykata Supreme e Kosovës me rastin e shqyrtimit të ankesave të palëve në procedurë, e duke vepruar sipas detyrës zyrtare, me Aktvendimin AP.nr.203/2011 të dt.26.04.2012, e ka anuluar aktgjykimin e shkallës së parë të kësaj gjykate, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe lëndën ia ka kthyer në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas udhëzimeve të Gjykatës Supreme, ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor, dhe pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, fillimisht sa i përket veprës penale Mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK-së, është tërhequr nga akuza për shkak se e njëjta është amnistuar, ndërsa që sa i përket tri veprave penale të Grabitjes nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së, ka bërë ricilësimin e këtyre veprave penale në një veprë penale, dhe atë në veprën penale Grabitje në vazhdimësi nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së, dhe pas ricilësimit të këtyre veprave penale, tani i akuzuari ka deklaruar se e pranon fajësinë për këtë veprë penale e cila i vihet në barrë.

Meqë i akuzuari e ka pranuar fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë për kryerjen e veprës penale, pranimin i cili është bërë vullnetarisht, pranimin i cili mbështetet në faktet e çështjes dhe provat materiale që përmban aktakuza, dhe se nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabim faktik, Gjykata vlerësoj se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore nga neni 248 të KPPRK-së, që të pranohet deklarata e të akuzuarit për pranimin e fajësisë për kryerjen e kësaj vepre penale, dhe të njëjtën edhe e ka aprovuar, duke mos administruar asnjë provë lidhur me vërtetësinë e gjendjes faktike.

Ashtu që, bazuar në një gjendje të tillë të pa kontestuar të fakteve, gjykata vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit A.H, manifestohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Grabitje në vazhdimësi nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së lidhur me nenin 81 të KPRK-së, ashtu

që të akuzuarin edhe e shpalli fajtor, dhe ia shqiptoj sanksionin penal përkatës, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se me vetë faktin e pranimit të fajësisë nga i akuzuari është vërtetuar gjendja si në dispozitiv të aktakuzës e që ky pranim është në përputhshmëri edhe me provat që gjenden në shkresat e lëndës. Andaj i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të sanksionit penal, të marrë si rrethanë lehtësuese faktin e pranimit të fajësisë nga i akuzuari, dhe faktin se nuk ka të dhëna se i njëjti ka kryer ndonjë veprë tjetër penale. Andaj i propozon gjykatës që të njejtin ta shpall fajtor dhe ta gjykoj sipas ligjit.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.H-av.Sh.B në fjalën përfundimtare i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit të marrë si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë, pendimin e tij, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej veprë penale, se kundër tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale ndaj tij, është familjar-baba i dy fëmijëve, duke kërkuar kështu nga gjykata që ndaj të mbrojturit të tij të shqiptoj një dënim sa më të butë.

I akuzuari A.H në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, duke shpreh keqardhje për veprën penale të kryer, se nga ajo kohë nuk ka kryer veprë tjetër penale, se kanë ndryshuar rrethanat familjare, tani është baba i dy fëmijëve, dhe i ka kërkuar gjykatës që ndaj të njëjtit të shqiptoj një dënim sa më të butë.

Gjykata me rastin e matjes dhe përcaktimit të lartësisë dhe llojit të sanksionit penal për të akuzuarin i ka vlerësuar të gjitha rrethanat relevante rënduese dhe lehtësuese dhe si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin ka gjetur faktin se i njëjti e ka pranuar fajësinë për veprën penale për kryerjen e të cilës është akuzuar, moshën e re gjatë kohës së kryerjes së veprës penale, se tani është familjarë -baba i dy fëmijëve dhe mbajtës i vetëm i familjes, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej veprë tjetër penale, koha e gjatë nga koha e kryerjes së veprës penale, e në mungesë të rrethanave rënduese, të akuzuarit i shqiptoj sanksionin penal si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se një sanksion i tillë penal është në përputhje të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj veprë penale dhe përgjegjësinë penale të të akuzuarit, dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në riedukimin, risocializimin dhe parandalimin e të akuzuarit por edhe personave të tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen me çka edhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit konform nenit 34 të KPK-së.

Vendimi mbi llogaritjen e paraburgimit në dënimin e shqiptuar është marrë konform nenit 83 par.1 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.2 nënpar.2.6 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, lidhur me kërkesën pasurore-juridike është marrë duke pas për bazë faktin se të dëmtuarit nuk kanë qenë prezent në seancën e shqyrtimit gjyqësor, ku i akuzuari e ka pranuar fajësinë, e po ashtu deri më tani me asnjë parashtrësë paraprakisht nuk e ka precizuar kërkesën në mënyrë të qartë, duke mos ia bashkangjitur provat konkrete, ashtu që të dhënat e mbledhura në procedurë penale, nuk

paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtë lidhur me këtë çështje, konform neni 463 par.1 të KPPRK-së.

Sa i përket veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPPRK-së gjykata ka marrë aktgjykim refuzues për shkak se prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza lidhur me këtë vepër penale, me arsyetimin që kjo vepër penale është përfshirë në ligjin për amnisti Nr.04/L-209.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti për Krime të Rënda**  
**P.nr.302/12, dt.20.07.2018**

**Bashkëpunëtori profesional**  
Driton Berisha

**Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari**  
Beqir Kalludra

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa  
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditëve  
nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.